

Përshëndetje nga Mongolia!



Ne jemi Margo dhe Paolo.

Ne po udhëtojmë përreth botës për të mësuar për fëmijët e Perëndisë. Bashkohu me ne teksa vizitojmë Mongolinë!



Ka rreth 3 milion njerëz në Mongoli dhe rreth 12 000 anëtarë të Kishës. Çfarë vë re te kjo fotografi që është njësoj në familjen tënde? Çfarë është e ndryshme?

Mongolia është në Azi, midis Kinës dhe Rusisë.

Në Mongoli ka më shumë kuaj sesa njerëz! Festalet mongole kanë gara me kuaj, gjuajtjen me hark, sportin e mundjes, vallëzimin dhe ushqim të shijshëm.



Ky është *Mormohpi Hom*, Libri i Mormonit.



Faleminderit që e eksplorove Mongolinë me ne. Shihemi herën tjetër!




Shumë familje në Mongoli jetojnë në kryeqytet, Ulan-Bator.



Familje të tjera jetojnë në fshat. Ata jetojnë në tenda që quhen *gers* dhe mbledhin kope kafshësh si jakë [lopë e Tibetit], kuaj dhe deve.



Jakët janë si gjedhët, vetëm se kanë më shumë qime.



Unë e di se Jezu Krishti është Biri i Perëndisë dhe se Ai më do mua dhe të gjithë fëmijët kudo. Më pëlqen shumë të shkoj në kishë dhe në Fillore, sepse kur shkoj atje mund të mësoj për Jezusin.

Bilegti, 7 vjeç



Unë e di se kemi një profet të gjallë, Presidentin Rasëll M. Nelson. Ai na mëson gjëra që janë të vërteta.

Gerelkimega, 4 vjeçe

A je nga Mongolia? Na shkruaj! Do të na pëlqente shumë të dëgjonim prej teje!